



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**FEDERATA SHQIPTARE E KARATESË**



# **KODI I ETIKËS**

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Karatesë

---

## TABELA E LËNDËS

<b>HYRJE</b> .....	<b>3</b>
<b>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</b> .....	<b>3</b>
NENI 1. BAZA LIGJORE.....	3
NENI 2. QËLLIMI .....	3
NENI 3. FUSHA E VEPRIMIT .....	3
<b>RREGULLAT E SJELLJES</b> .....	<b>3</b>
NENI 4. PARIME TË ETIKËS .....	3
NENI 5. DETYRIMET .....	4
NENI 6. POLITIKAT ANTIDISKRIMINUESE.....	4
NENI 7. KONFIDENCIALITETI I INFORMACIONIT .....	4
NENI 8. NGACMIMET SEKSUALE.....	5
NENI 9. KONFIKTI I INTERESAVE .....	5
NENI 10. PROCEDURAT NË RAST KONFLIKTI INTERESI.....	6
NENI 11. DHURATAT DHE FAVORET .....	6
NENI 12. VEPRIMTARITË E ZYRTARËVE .....	6
<b>MASAT DISIPLINORE</b> .....	<b>7</b>
NENI 13. RAPORTIMET E SHKELJEVE.....	7
<b>DISPOZITA PËRFUNDIMTARE</b> .....	<b>7</b>
NENI 14. HYRJA NË FUQI.....	7

## **HYRJE**

Ruajtja e integritetit dhe vlerave në sportin e karatesë në Shqipëri është qëllim i përhershëm i Federatës Shqiptare të Karatesë. Në këtë kuadër kjo Federatë përpiqet që të luftojë fenomene, metoda apo praktika të pamoralshme dhe joetike që dëmtojnë imazhin e Federatës dhe të vetë sportit në përgjithësi. Për këtë qëllim, Komiteti Drejtues i FSHK-së miraton këtë Kod Etike.

## **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1. Baza Ligjore**

Kodi i Etikës (këtu e në vijim “**Kodi**”) është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 9376 datë 21.04.2005 “*Për Sportin*” i ndryshuar, në Statutin e Federatës Shqiptare të Karatesë (këtu e në vijim “**FSHK**”) miratuar me Urdhër Nr. 54 datë 25.02.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Rregullores së këtij institucioni si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, që lidhen me fushën e veprimit të këtij Kodi.

### **Neni 2. Qëllimi**

Kodi i Etikës ka për qëllim të vendosë rregulla për sjellje profesionale për anëtarët e Federatës, duke përfshirë personelin ekzekutiv dhe administrativ, sportistët dhe trajnerët. Ky Kod informon të gjitha palët e interesuara mbi politikën dhe procedurat e etikës e të sjelljes së FSHK-së, mbi shkeljet e mundshme të etikës dhe të rregullave të papajtueshmërisë së FSHK-së.

### **Neni 3. Fusha e Veprimit**

3.1 Kodi i Etikës është i detyrueshëm për zbatim mbi të gjithë anëtarët e Federatës, duke përfshirë zyrtarët, trajnerët, gjyqtarët, sportistët, etj.

3.2 Zyrtarë konsiderohen të gjithë anëtarët e Komitetit Drejtues të FSHK, drejtuesit e komisioneve, të sekretarisë, gjyqtarët, trajnerët dhe të gjithë personat përgjegjës për çështjet teknike, mjekësore apo administrative në FSHK, anëtarët e FSHK-së dhe çdo subjekt që merr pjesë në veprimtaritë zyrtare që organizon FSHK.

## **RREGULLAT E SJELLJES**

### **Neni 4. Parime të Etikës**

Të gjithë individët mbi të cilët zbatohet ky Kod, duhet të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme të etikës:

- a) Integriteti;
- b) Respekti i ndërsjellë dhe dinjiteti njerëzor;

- c) Shumëllojshmëria e mendimeve, kulturave gjinore dhe etnike;
- d) Përgjegjësia personale e institucionale dhe llogaridhënia;
- e) Ndjenja e komunitetit;
- f) Ndjeshmëria ndaj shqetësimeve të veprimtarive në punë;
- g) Përgjegjësia qytetare.

### **Neni 5. Detyrimet**

Të gjithë subjektet mbi të cilët zbatohet ky Kod kanë detyrimin:

- a) Të promovojnë interesat më të mira të FSHK-së;
- b) Të nxisin misionin, vizionin dhe vlerat e FSHK-së;
- c) Të ruajnë respektin dhe besimin e publikut ndaj FSHK-së;
- d) Të shfaqin integritet personal, ndershmëri dhe përgjegjësi në të gjithë veprimtarinë e tij;
- e) Të sigurojnë një ambient të respektit reciprok, të paanshmërisë dhe bashkëpunimit;
- f) Të ruajnë fshehtësinë e të gjitha çështjeve që konsiderohen konfidenciale;
- g) Të sigurojnë pavarësinë e gjykimit të lartë nga interesat kontradiktore;
- h) Të sigurojnë që marrëdhëniet që janë ose mund të perceptohen si konflikte interesi;
- i) Të jenë plotësisht të hapur dhe të ndiqen nga udhëzimet e Federatës;
- j) Të ketë përputhshmëri me politikat dhe procedurat e FSHK-së dhe ligjet në fuqi.

### **Neni 6. Politikat Antidiskriminuese**

FSHK duhet t'i japë mundësi të barabarta çdo personi gjatë procesit të rekrutimit, emërimit, promovimit, pagesave, trajnimeve dhe praktikave të tjera të zbatuara në Federatë pa dallim gjinie, race, origjine etnike, origjine kombëtare, ngjyre, besimi, feje, moshe, uniformë të shërbimit apo statusi që ai përfaqëson, me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike apo edhe bindjeve politike. I gjithë personeli i Federatës pritet të përshtatet me politikën antidiskriminuese të institucionit.

### **Neni 7. Konfidencialiteti i Informacionit**

Personelit të Federatës i besohen informacione personale dhe institucionale, të cilat duhet të trajtohen me konfidencialitet dhe të përdoren vetëm për kryerjen e punës në këtë institucion. Respekti për privatësinë personale dhe individuale kërkon ushtrimin e kujdesit dhe të gjykimit. Përveç rasteve kur kërkohet ose lejohet nga ligjet apo rregullat e FSHF-së, informacionet dhe të dhënat personale apo institucionale të stafit të Federatës nuk duhet t'u jepen palëve të treta pa pëlqimin e individëve në fjalë. Kur ekziston dyshimi në lidhje me konfidencialitetin e informacionit, anëtarët e personelit të Federatës duhet t'a konsiderojnë informacionin si konfidencial deri në marrjen e një vendimi ndryshe.

## **Neni 8. Ngacmimet Seksuale**

8.1 Për të nxitur një ambient respekti për dinjitetin dhe mirëqënien e çdokujt prej anëtarëve të FSHK-së, kërkohet angazhim për të krijuar një ambient pune pa asnjë lloj ngacimimi. Ndalohet ngacmimi verbal ose joverbal dhe ai seksual ndaj çdo sportisti dhe çdo anëtar tjetër të personelit të Federatës në çdo nivel hierarkie.

8.2 Ngacmim seksual do të thotë kërkesa për favore seksuale dhe veprime të tjera elektronike, verbale, vizuale, të shkruara ose jo të një natyre seksuale ku:

- a) një sjellje e tillë në formë eksplicite ose implicite angazhohet si kushti bazë për vendime që prekin afate ose kritere pjesëmarrjeje në çdo program, organizatë, aktivitet, status ose vlerësim;
- b) një sjellje e tillë ka për qëllim ose ndikon padrejtësisht në të drejtën, privilegjin, avantazhin, ose mundësinë e sportistit;
- c) një sjellje e tillë është aq e dukshme ose e ashpër sa krijon një mjedis kërcënues, stresues, armiqësor, apo uryes për zhvillimin e procesit sportiv.

## **Neni 9. Konflikti i Interesave**

9.1 Besimi në FSHK vihet në rrezik kur sjellja e një anëtar tjetër të personelit të FSHK-së përfshihet ose duket sikur përfshihet në një konflikt mes interesave personale dhe detyrimeve ndaj FSHK-së.

9.2 Anëtarët e personelit të FSHK-së duhet të shmangin sjelljet që çojnë anëtarët e publikut të gjerë të konkludojnë se ai/ajo po përdor postin e tij për interesa vetjake profesionale apo interesa të ndonjë të afërmi të tij. Në raste të tilla konfliktesh apo të perceptuara si të tilla nevojitet largimi dhe mënjanimi nga çështja apo situata.

9.3 Konflikt i interesit është konflikti ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të drejtpërdrejta ose të tërthorta të një Zyrtari të Federatës, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij në FSHK. Në kuptimin e kësaj rregulloreje, “Zyrtar” i Federatës quhet, Presidenti, Sekretari, anëtarët e Komitetit Drejtues si dhe kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të ndryshme të Federatës. Konflikti i interesit përfshin:

- a) Kur interesat personale të një Zyrtari ndërhyjnë me interesat e FSHK-së;
- b) Kur një Zyrtar apo një i afërm i tij përfiton në mënyrë të padrejtë apo të tërthortë të mira materiale apo financiare për shkak të pozicionit të Zyrtarit në FSHK.
- c) Kur një Zyrtar, pa pasur lejen paraprake të Komitetit Drejtues, ka marrëdhënie pune apo është anëtar i organeve drejtuese për një federatë tjetër.
- d) Kur Zyrtari përdor apo ndan me të tjerët informacion konfidencial të FSHK-së për përfitime personale apo për përfitime të të afërmeve të tij.
- e) Kur Zyrtari pranon përfitime personale (p.sh. më shumë se sa një dhuratë modeste) nga një person apo organizatë që ka lidhje apo pret të bashkëpunojë me FSHK-në në çfarëdo lloj transaksioni biznesi;

- f) Kur Zyrtari merr vendime për favorizim të personave në këmbim të mbeshtetjes së tyre në zgjedhjet e përgjithshme apo organet drejtuese të FSHK-së.

### **Neni 10. Procedurat në Rast Konflikti Interesi**

10.1 Kur Zyrtari mendon se mund të përballlet me një situatë të mundshme të konfliktit të interesit, ai duhet t'ja bëjë të ditur situatën Komitetit Drejtues dhe të marrë aprovimin e tij për kryerjen apo moskryerjen e veprimit të pritur.

10.2 Në rastin kur Zyrtari me konflikt të mundshëm interesi është anëtar i Komitetit Drejtues, ai nuk mund të votojë për t'u shprehur në lidhje me veprimin që mund të jetë në konflikte interesi. Vendimi merret nga anëtarët e tjerë të Komitetit Drejtues duke përjashtuar votën e tij.

### **Neni 11. Dhuratat dhe Favoret**

11.1 Anëtarët dhe personeli i Federates nuk duhet të kërkojë ose të pranojë, dhurata, favore, ose çfarëdo përfitimi tjetër, ose shmangie të humbjeve të mundshme, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie pune, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë në kryerjen e detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare. Kjo nuk zbatohet në rastin e festave të zakonshme, të mikpritjes tradicionale, të dhuratave me vlerë simbolike ose tradicionale, të mirësjelljes, të cilat nuk krijojnë dyshime mbi paanshmërinë e personelit.

11.2 Në qoftë se anëtarit të personelit i ofrohet një avantazh i padrejtë, ai duhet t'a refuzojë, pa patur nevojë t'a pranojë atë për ta përdorur si provë dhe të raportojë përpjekjen tek eprori i tij ose te njësia e personelit;

11.3 Drejtuesve dhe anëtarëve të Komisioneve të FSHK-së, ju ndalohet që në kryerjen e detyrave të tyre të pranojnë ose premtojnë favore ose për të negociuar marrëveshje të çdo lloji qofshin, me përjashtim të rasteve kur organi drejtues i institucionit e ka bërë të qartë se e lejon një gjë të tillë.

### **Neni 12. Veprimtaritë e Zyrtarëve**

Të gjithë anëtarëve të FSHK-së ju ndalohet që të marrin pjesë, direkt ose indirekt, në veprimtari të ngjashme që lidhen me sportin e karatesë dhe në aktivitetet sportive ku FSHK-ja nuk është anëtare ose nuk jep miratimin për zhvillimin e tyre. Ata ndalohet të marrin pjesë aktivisht ose pasivisht në organizata që nxisin, ndërmjetësojnë, organizojnë ose kryejnë veprimtari të tilla. Zyrtarëve ju ndalohet të marrin pjesë direkt ose indirekt në përpjekje për paracaktimin apo manipulimin e rezultatit të një ndeshjeje në aktivitetet e karatesë ose të një pjese të caktuar të saj.

## **MASAT DISIPLINORE**

### **Neni 13. Raportimet e Shkeljeve**

Çdo person që është subjekt i zbatimit të dispozitave të këtij Kodi ka të drejtë të denoncojë apo raportojë shkelje të dispozitave të këtij Kodi, përpara anëtarëve të Komitetit Drejtues. Zyrtarët duhet të raportojnë çdo shfaqje të shkeljeve të sjelljes te Sekretari i Përgjithshëm i FSHK-së i cili i përcjell ato për vendim në Komitetin Drejtues. Komiteti Drejtues ja përcjell shkeljet që gjykon të provuara dhe të arsyeshme Komisionit të Disiplinës për marrjen e masave përkatëse.

## **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 14. Interpretimi**

Komiteti Drejtues i FSHK-së është i autorizuar të japë interpretime autentike të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 15. Hyrja në Fuqi**

Ky Kod hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Komiteti Drejtues i FSHK-së. Çdo rregullore tjetër që ka të bëjë me etikën dhe sjelljen e zyrtareve, trajnereve, sportistëve mbetet në fuqi, për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi.

( \_\_\_\_\_ )

( Vula e FSHK-së )